



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/355

Datë: 14.07.2023

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së-IV- (katërt) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

**R E N D I D I T Ë S**

1. Shqyrtimi i Raportit Financiar tremujor Janar-Mars për vitin 2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/276 datë:18.04.2023, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin fiskal 2023.
3. Shqyrtimi i Planit vjetor të Prokurimit publik.
4. Formimi i Këshillit organizativ për kremtimin e 16 qeshorit, Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta për vitin 2023.
6. Shfuqizimi i vendimit nr.02/6 datë:07.02.2023, për listën e veqantë të pronave të paluajtshme të komunës.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.08/503 datë:30.11.2022, e parashtruar nga Zijadin Paqarizi.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/210 datë:20.04.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.390 datë:05.09.2022, e parashtruar nga Sabit Mazreku.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/199 datë:06.04.2023, e parashtruar nga Luljeta Telaku.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/111 datë:27.02.2023, e parashtruar nga Sala Krasniqi.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/138 datë:14.03.2023 e parashtruar nga Naile Krasniqi.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/141 datë:16.03.2023, e parashtruar nga Shahe Thaçi.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/151 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Lema Paqarizi.

15. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë:28.04.2023 dhe filloi në ora:14:25. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 26 asambleistë, nënkryetari, drejtorë komunal, dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e katërt të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Para se të fillojmë më rendin e ditës, a ka dikush të deklaroj ndonjë qështje jashtë rendit të ditës?

Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Është shqetësuese që në seanca ka mungesë të drejtorëve, sepse ne kemi qështje që t'i diskutojmë me ta.

Sa i përket fillimit të seancës, Kryesues është mirë që çdo vonesë të njoftohet Kuvendi me kohë. Është mirë që Kuvendi kur do që të thirret, të fillojë me kohë, ose përmes grupit në vatsapp që e keni të na njoftoni për seancë nëse vonoheni.

Nënkryetar, unë e di që ekziston një kontrat për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Nuk ka rrugë lokale që nuk është e prerë dhe që është me gropa. Rruga e Senikut nga marketi lartë e deri në hyrje e Lladrocit është e pa kalueshme dhe don intervenim urgjent.

Neve na brengos një qështje rruga "Ibrahim Mazreku" ajo pjesa nga lumi poshtë, ka një kohë të gjatë stagnimi, dhe bizneseve atje ju shkakton problem. Në rregull që punohet, mirëpo duhet të ketë alternativa tjera për kalimin e njerëzve krahas bizneseve ku i kanë. Punimet nga Lindi deri te ambullanta një kohë janë ndalu punimet.

Parku i qytetit, ato kompani që janë duke punuar aty mirë është që të pastrohen rrugët. sepse ka një pluhur të jashtëzakonshëm. Është mirë të ndërmerren masa në këtë hapë.

Te pastrimi i deponive inerte dhe jo inerte dhe aty sa e di unë është një kontratë dhe nga fshati Lladroc deri këtu janë diku 4-5 deponi dhe është mirë të merren masa në këtë drejtim.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

Lus kryesuesin që ato marrveshjet ose pazaret individuale për interesa personale të përfundojnë para afatit të asambles. Është shqetësuese ku në seanca mungojnë drejtorët. Drejtori i Shëndetësisë 1 vit e gjysmë u bë që asnjëherë në seanca nuk është ardhë, por nëse nuk mundet drejtori, duhet të vij zëvendësdrejtori ose shefi, sepse dikush duhet të jap shpjegime për kërkesat që ne i bëjmë. Një konkurs që është hapur, në bazë të informacioneve që kemi ka shkuar në mënyrën më të keqe të mundshme. Fatkeqësitë janë bërë emrime partiake, politike dhe janë zgjedhur njerëz me marrveshje 15 nga NISMA dhe 5 nga LDK-ja. Është bërë një maketing i

madh që është duke u bërë një investim kapital në infrastrukturën e qendrës së mjeksisë familjare, që është më shumë një fushatë politike, sesa ndonjë investim që është bërë. Ju nuk po investoni në shërbime, po mundoheni me fasada t'i bindeni qytetarët.

Në dikasterin e stomatologjisë dhe gjinekologjisë mjeku punon deri në ora:13:00, duhet të na sqaroni pse nuk punojnë pas orës:13:00.

Çka është për tu përshëndetur është bërë një projekt nga Drejtoria e Shërbimeve Publike mjellja e disa drunjëve nëpër fshatrat Damanek dhe Drenoc. Unë kisha kërkuar që ditëve të thata, është mirë të ketë një kujdes të veçantë që të ujiten ata drunjë, në ndonjë marrveshje me kompaninë e ujësjellësit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesa!

**Agnesa Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

Është bërë tani traditë që Kuvendi Komunal të fillojë gjithmonë me vonesë, mirëpo kjo e sotmja ishte një degradim i institucionit të Kuvendit komunal. Njoftimin që e bërë 3 orë me vonesë do duhet ta bëjë më kohë.

Qështja që do e ngris ka të bëjë me drejtorin e arsimit, lidhur me anulimin e eksuzionit të Gjinnazit "Hamdi Berisha", meqenëse në vendimin që e kanë marrur drejtoria e arsimit nuk specifikohen arsyet konkrete se pse është anuluar ai eksuzion i maturantëve, vetëm shënon që bazuar në vonesat e organizimit, që kanë bërë mos me u respektu Udhëzimi i Ministries së Arsimit, për këtë pasojë është anuluar. Është mirë të na jepet një sqarim pse kanë ndodhur këto vonesa, për çfarë vonesa konkretisht bëhet fjalë dhe a është rishpallë konkursi. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Përshëndetje për të gjithë!

Me keqardhje po e themë që në Kuvend vetëm punë nuk është duke u bërë më Kryesues, përveq vonesave, ne nuk kemi as ku të ulemi. Sa herë kemi bërë thirrje me i rregullu kamerat, me e funksionalizu punën e Kuvendit, nuk e di ku ka ngecur puna, sepse buxhet ka komuna për dreka e darka zyrtare, e nuk po ka buxhet me na mundësu një punë të mirëfilltë për të cilën jemi votuar dhe jemi të thirrur.

Ndërprerja e punimeve në rrugën "Ibrahim Mazreku" pse po ndodhë kjo.

Janë projektet që janë në vazhdimësi që janë prej mandateve të kaluara nëpër buxhetet komunale të cilat janë injorur. Është trotuari në rrugën "Hilmi Hoti" 1300m, nga viti 2019 ka qenë në projekt buxhet komunal dhe asnjëherë nuk është realizu. Janë dy parqe në Carrallukë të cilat kanë qenë në buxhet dhe nuk janë realizu kurr.

Kam marrur një ankes nga një qytetar në fshatin Berishë për disa villa që janë duke i realizuar atje e që po shkon drejtë degradimit hapsinorë. Ato ndërtime a janë duke u bërë në zonën kadastrale të Komunës së Malishevës?

Qështja e punësimeve në QKMF-ë dhe në çerdhe, aty profesionalizëm nuk ka, të gjithë janë gra të drejtorëve, miq e dhanur.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Përshëndetje për të gjithë!

Po na përsëritet pyetja për drejtorë disa herë, për mungesë të drejtorëve. Asnjë drejtorë nuk e ka me borgj ose nuk e obligon ligji me ardhë këtu në seancë. Ligji e obligon me qenë këtu kryetari i komunës, nënkryetari i komunës. Nëse keni pyetje drejtuar ekzekutivit është përfaqësuesi i ekzekutivit, kryetari, nënkryetari që ja përcjellë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Mirëindë!

**Mirëinda Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Si qështje kryesore unë dua ta ngjis është se materiali nuk ka ardhur sipas kohës së parapara me ligjore, si për KPF-ë ashtu dhe për mbledhjen sot që jemi duke e mbajtur.

Qështja tjetër është që viteve të kaluar kemi pasur disa punëtorë nëpër fshatra që janë marrur me mirëmbajtjen e fshatit, unë kisha kërkuar nga ju nënkryetar që të paktën të hyjë në funksion që të jetë një punëtorë nëpër fshatra siç ka qenë më herët, sepse gjendja ka qenë më e mirë.

Qështja tjetër është hudhja e mbeturinave që është jo e mirë, unë kisha dhënë vërejtje dhe për qytetarët që mos të hudhen mbeturinat ku nuk duhet. Disa tabela janë vendos që mos të hudhen mbeturinat dhe është mirë që kjo të bëhet në shumë lokacione, të dilni në teren dhe të shihni se ku është e nevojshme të vendoset ajo shejë që mos të hudhen mbeturinat pa vend.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim!

**Burim Paqarizi:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam një shqetësim, përveq pjesës tjetër që ishte pjesa e dytë e rrugës "Ibrahim Mazreku" që ka ngecje dhe vonesa, dhe bizneset kanë ankesa që nuk po mundën të lëvizin lirshëm dhe po kanë dëme të shumta. Kam një sygjërim ose vërejtje që te rruga e tranzitit të bëhet një intervenim sa më i shpejtë, sepse është dëmtuar shumë për shkak të peshave të rënda.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, nënkryetar!

**Vesel Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë!

Do ju përgjigjem pyetjeve që i ngritët. Z. Bibaj rreth mirëmbajtjes së rrugëve kemi një kontrat dy vjeqare dhe kontrata ende vazhdon dhe vazhdimisht janë duke u mirëmbajtur rrugët, por është e vërtetë se kemi dëmtim të rrugëve dhe është e pamundur që në të njëjtën kohë të përfundohet të gjitha. Është mirë që ju t'i drejtori Drejtorisë së Urbanizmit me kërkesa dhe ne pastaj ti trajtojmë ato.

Rreth vanesave te rruga "Ibrahim Mazreku", nëse një projekt ka mu kry në kohë optimale, ky projekt do të jetë dhe ne mendojmë që me 16 qeshor do e prejme shiritin. Janë disa pauza të vogla që është për shkak të KEDS-it dhe një problem tjetër e kemi pasur një lum nëntokësor tek lagjia e gurit dhe jemi detyruar me kompanin që ta bëjmë një zgjidhje alternative, një devijim të kanalizimit në mënyrë që në të ardhmen mos të kemi vërshime.

Te pluhri, ne jemi duke u përkujdes së bashku me mbështetjen e patrullave të policisë që mos të

pengohet komunikacioni, qoftë me pluhën, me derdhje të dheut gjatë rrugës, mirëpo ku punohet dhe qohet pluhën mirëpo po bëjmë përpjeke që me qenë sa më pak. Te mbeturinat inerte ne kemi nënshkruar një kontratë me një operator ekonomik që ka fillu të bëjë eliminimin e mbeturinave inerte. Kërkojmë prej gjithë qytetarëve që mbeturinat inerte tash e tutje të hudhen në vendet e caktuara.

Te mos pjesmarrja e drejtorëve kjo qoftë nivelin qendror por edhe lokal përcillen me këto dukuri, unë them se është e mirë me pasë prezencën e tyre, mirëpo vetë pjesmarrja e kryetarit ose nënkryetarit unë besoj që nuk len vakum për mos me u shtjellu temat, shqetësimet, vërejtjet e juaja.

Tek Investimi në QKMF-ë është mirë që qdo investimi ti gëzohemi dhe ai investim ka qenë i domosdoshëm, e nevojshme sepse një pjesë e saj ka qenë e pa shfrytëzueshme dhe sot shfrytëzohet.

Te mjekët të cilët nuk gjenden në orarin e punës, unë kërkoj prej gjithë juve dhe gjithë qytetarëve të cilët janë duke na përcjellë këto dukuri negative që hasen të na lajmrojnë dhe neve që organet kompetente kanë me marrë masat e duhura, sepse orari për mjek është deri në ora 15:00.

Te mbjellja e drunjëve, kompania që është kontraktuar nuk e ka përgjegjësin vetëm mbjelljen e drunjëve por dhe mirëmbajtjen për aq sa e ka kontratën.

Pse është anuluar konkursi i maturanëve, sigurisht që çdo parregullsi që mund të shkojë gjatë proceseve do të anulohet dhe është përgjegjësi e drejtorisë së arsimit, sepse ka qenë vetëm një operator, i cili pastaj ka mund të manipulojë me qmimet e tyre dhe ka qenë në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ. Në të njëjtën ditë është bërë ftesë për aplikimin e operatorëve ekonomik të cilët merren me transportin e maturanëve.

Vetoni, pati një shqetësim të trotuarit Hilmi Hoti saktë nuk e di saktë, do jap sqarim herën tjetër sepse nuk po e di në cilën kontratë, ku është e planifikime. Kontrata e trotuarëve-pranimi teknik është bërë para dy ditë.

Ndërtimi i villave në Berishë, kjo është në pjesën e Drenasit, jo në pjesën tonë të komunës së Malishevës.

Te mirëmbajtja nëpër fshata, më herët ka qenë kjo kontratë, mirëpo tani nuk e kemi. Ne jemi duke e shqyrtuar që ta bëjmë angazhimin apo kontraktimin e një kompanie e cila pastaj do të ketë mundësi të mirëmbajë dhe shumë shpejtë do ta kemi një procedurë.

Burimi, e pati një kërkesë që të mirëmbahet rruga e tranzitit, është e vërtetë që është dëmtuar, mirëpo kjo dihet për faktin e punimeve në rrugën "Ibrahim Mazreku" dhe në momentin që do rregullohet kjo rrugë ne do kemi rast në buxhetin e 2024 ne do kërkojmë projekt që të bëhet rregullimi i kësaj rruge.

Argjend Thaçi: Kalojmë tek rendi i ditës. Nëse nuk e do askush fjalën kush është për rend të ditës?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 10

Me 14 vota për, asnjë kundër dhe 10 abstenime miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë: Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor janar-mars për vitin 2023. Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë!

Nga ky Kuvend është aprovuar buxheti për vitin 2023, në vlerën prej 18,124,837.00E për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kur kësaj i shtojmë shumën prej 1,140.35E nga disa donacione të vogla të bartura nga shumë vite, shumën prej 7,523.16E shtesa në paga sipas ligjit të pagave, del se buxheti i futur në SIMFK si buxhet përfundimtar kap shumën prej 18,133,500.51E.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë Janar-Mars 2023 kap shumën prej 10,264,296.06E, çka do të thotë se shkalla e realizimit (alokimit) të buxhetit, në këtë periudhë është 56.60%.

Sipas shënimit të librit të thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar (alokuar) për periudhën janar-mars 2023 është 50.55%. Kurse përqindja e tërsishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është 28.62%.

Në Raportin që e kemi prezantuar para jush te pasqyrja e të hyrave mungojnë të hyrat nga gjambat në trafik dhe nga gjykatat, për shkak se kanë ardhur me vonesë shënimet, mirëpo në KPF-ë e kemi plotësuar atë pjesë dhe nuk e di a ka ardhur materiali shtesë.

Të hyrat e realizuara deri dhe janë 563,619.88E që në përqindje sillet rreth 50% e realizimit të të hyrave për këtë vit. Pa përfunduar 4 mujorshi i parë është realizuar pothuajse 50% e të hyrave.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Në grandin për performancë të vitit të kaluar shpenzimi i buxhetit ka qenë diku 99.7%, mirë që është realizuar buxheti mirëpo mua me intereson se a janë përfunduar projektet, apo buxhetin e keni shpenzuar duke i paguar obligimet për projektet që kanë mbetur. Një qështje tjetër që do e ngris është te vendimet gjyqësore 119.000E është një vlerë e madhe dhe a mund të na sqarosh nga cilat vendime gjyqësore bëhet fjalë, a janë vendime nga arsimi apo cilat. Ne e kemi diskutuar disa herë këtë qështje që të gjindet një zgjidhje dhe me Ministri dhe me akterët në kuadër të qeverisë, sepse po na marrin shumë mjete të taksapaguesve të komunës. Shërbimet intelektuale janë 2,700E, këtu është një rritje dhe a mund të dalin me ndonjë kod që të sqarohen më mirë.

Shërbimet e arsimit, trajnimet janë 3,200.00 E, ndërsa në vitin 2022 nuk ke pasur shpenzime fare.

Shërbimet korrektuese tjera 163,994.89 E kjo është një vlerë e rritur. Paisjet tjera në vitin 2022 është 0, ndërsa në vitin 2023 është 37,424.40E. Është mirë te secila pjesë të na jepet arsye pse janë rritur këto shpenzime dhe çka nënkupton kjo pjesë.

Furnizime pastrimi në vitin e kaluar nuk kemi pasur, ndërsa në këtë vit janë 7,593.94E. Unë mendoj që prapë te furnizimet e pastrimit do të ketë investime sepse kanë nevojë shkollat.

Provizionit bankar në këtë vit janë 3,858.15E, na sqaro çka nënkupton me provizion bankar?

Te drut prapë është një rritje zakonisht e madhe, 70.000.00E janë në vitin 2022, ndërsa në vitin 2023 janë 176,357.23E.

Karburantet për vetura, ka pasur rritje të karburanteve e kuptojmë, mirëpo në të njëjtën kohë

drejtorët komunal është mirë ti ndalin veturat zyrtare jashtë orarit zyrtar. Është mirë që këto të ndalohen me një vendim.

Te mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve ka një rritje prej 4,000.00E.

Reklama dhe konkuse dhe këtu ka një rritje, dhe na jep sqarim çka nënkupton kjo, a është për gazeta zyrtare apo si.

Drekat zyrtare janë rritur për 5,000.00E. Te projektet kapitale të Drejtorisë së shërbimeve publike te rregullimi i rrugës "Ibrahim Mazreku" a nënkuptojmë me projektin e tanishëm.

Në qfare niveli ka shkuar kolektori kryesor Bubël-Lubizhdë, në çfarë faze e kemi?

Te ujesjellësi Bellanicë, Gajrak, Gurishtë, Dragobil, Pagarushë, Bubavec, nuk e di a ka ndonjë lëvizje të ujsjellsit, sepse disa herë janë duke u ndarë mjetet.

Drejtor, tek tabela 8.3 pres një përgjigje konkrete te ndërtimi i rrugës anësore te lumi Mirusha në Malishevë, është vlera 292,932.00E. Sa e di unë këtu i kemi tërheq 200,000.00E dhe janë dërguar në projekte tjera dhe pse është bërë si vlerë e projektit këtu.

**Argjend Thaçi: Urdhëro, Valjetë!**

**Valjetë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!**

Te tabela shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike disa prej pikave që më kanë rënë në sy janë drekat zyrtare ku kemi një rritje. Në vitin 2022 janë 3,236.70E, kurse në vitin 2023 janë 8,665.00E.

Mirëmbajta dhe riparimi i automjeteve në vitin 2023 janë 8,732.98E, ndërsa në vitin 2022 janë 4,238.30E.

Furnizime mjeksore-nuk po më duket kaq e arsyeshme për një periudhë kaq të shkurtër kjo shumë kaq e madhe dhe nëse shkojmë atje ka mungesa të shumta.

Furnizime zyre në vitin 2022 kanë qenë 7,946.55E, ndërsa në vitin 2023 janë 23,548.28.

Shërbimet për antarsim dhe paisjet tjera nëse ka mundësi një shpjegim më të detajuar për këtë pikë. Faleminderit!

**Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!**

**Veton Zogaj: Tek të hyrat vetanake e kam thënë dhe në KPF-ë që doket një farë dallimi më i avancun në krahasim me vitet paraprake, në këtë rast dhe me vitin 2022. Si komunë kemi një rritje te të hyrat vetanake, gjë që ka reflektuar dhe për rritjen e buxhetit, ose mundësi për të pasur investime në të ardhmen. Mirëpo prapë kemi ngecje në disa sektor të cilët po mendoj që e kanë mundësinë me pas më shumë të hyra vetanake.**

Gjjobat nga inspektoriati në vitin 2022 janë 25.00E gjjobë prej inspektoriatit, ndërsa në vitin 2023 janë 357.00E gjjoba. Ne e kemi çdo ditë pasqyr që ka shkelje qoftë nga biznesi, nga operatorë të ndryshëm ekonomik të cilët ka mundësi të gjobitën për shkak të shkeljeve që i bëjnë dhe inspektoriati nuk e bënë.

Licenca tjera për afarizëm- këto bizneset që aplikojnë për licencim në vitin 2022 kanë qenë 30.00E, ndërsa në vitin 2023 janë 130.00E që është shumë e ulët dhe e papërfillshme në raport me atë çka mund me brë në këtë dikastier.

Taks për qertifikat të pronësisë dhe kopje plani dhe këtu është shumë minimale 974E. Pranimi teknik i lokaleve ka qenë zero në vitin e kalum, ndërsa në këtë vit është 30E, kjo shumë është e papërfillshme. Ka plotë objekte që po ndërtohen dhe po jepen në shfrytëzim dhe nuk e ka këtë taksën komunale.

Vërejtja më e madhe është të agjensioi i pyjeve që ka zero të hyra nga kjo kategori dhe është në shpërputhje të fortë me atë që ne e shohum në teren.

Shërbime të ndryshme intel në vitin 2022 kanë qenë zero, ndërsa në këtë vit janë 2,700.00E. Shërbimet e arsimit, trajnimet në vitin e kalum ka qenë zero, ndërsa në këtë vit është 3,200.00E. Shërbimet kontraktuese tjera, unë kam kërkuar që kjo tjera të specifikohet, mirëpo nuk na ka ardhur e përmirsuar. Unë prapë po insistoj të di çka nënkupton të tjera.

Shërbime teknike në vitin 2022 janë zero, ndërsa në këtë vit janë 2,147.40E.

Shërbime të varrimit- ne e kemi një kontrat me BIK-un dhe këtu janë krijuar shpenzime 13,340.00E.

Paisje tjera- qka nënkupton tjera 37,424.40E në vitin 2023, ndërsa në vitin e kaluar ka qenë zero. Furnizim i zyreve 23,548.28E në vitin 2023, ndërsa 7,946.55E në vitin 2022, ka shumë diferencë të madhe këtu.

Furnizim mjeksore në këtë vit janë 38,265.48E, ndërsa në vitin e kalum janë 28,163.46E.

Dru-këtu e kemi arsyuar gjithmonë më shumë se sa duhet dhe me sa kam informacion këto institucionet publike tashmë kanë kaluar nga druri në pelet. Kjo shifër do të duhet me u zvoglu.

Karburant për vetura në këtë vit janë 33,291.84, ndërsa vitin e kalum janë 27,462.38E.

Mirëmbajtja dhe riparim i veturave poashtu ka dyfishim. Mirëmbajtja rutinore duhet të specifikohet se çka po bëhet fjalë. Drekat zyrtare kemi më shumë se dyfishim, nga 3,236.70 E që kanë qenë në vitin 2022, në vitin 2023 janë 8,665.00E.

Vendime të gjykatave zero ka qenë vitin e kalum ndërsa në këtë vit janë 8,479.38E.

Ndërtesat janë 284,709.96E, qka janë shpenzuar këtu- duhet të specifikohet për cilat ndërtesa po bëhet fjalë.

Ndërtim i rrugëve në këtë vit është 1,130,424.51E- duhet të ketë një specifikim për cilat rrugë po bëhet fjalë.

Kanalizime është një shifër shumë e lartë 55,653.63E. Mirëmbajtja investive- çka është kjo e cila ka një shifër prej 324,393.79E. Faleminderit!

**Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!**

**Valon Mazreku: Përsëndetje për të gjithë!**

Ajo çka ishte pozitive është se ishte një trend i mirë i shpenzimit të buxhetit, poashtu është një trend i mirë i realizimit të të hyrave. Të hyrat nga gjobat në trafik, të hyrat nga gjykatat dhe të hyrat nga agjensioni pyjor, nuk janë të hyra të cilat planifikohen nga komuna. Janë të hyra që planifikohen nga institucionet përkatëse, ata i mbledhin dhe i shpërndajnë. Diku rreth 4% ka një rritje të të hyrave vetanake, poashtu dhe tek shpenzimet diku mbi 95% e projekteve kapitale janë aloku të gjitha mjetet brenda këti 3 mujorshi. Konsideroj që kjo është një aspekt pozitiv për komunën.

Qështjet të cilat i ngritët te pjesa analitike, mirëpo plani cotabel i ka të specifikume kodet dhe nuk mundesh me i ndërru kod aty. Nëse nuk ka adekuat duhet me gjetë një të përafërt ose me vendos te shërbimet e tjera kontraktuese.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaçi:** Sa i përket pyetjes se Nebihut për qështjen e realizimit të shpenzimit për projektet e planifikuara për vitin 2022, përveq ato projekte të cilat kanë kërku ndërrim destinim në fund të vitit me kërkesë tonë, dhe është aprovuar nga ky Kuvend, të gjitha projekte tjera janë realizu dhe është bërë shpenzimi sipas planifikimit. Ne i kemi sjellë disa projekte me i ndërru në kuadër të kësaj që përmende ka qenë vitin e kaluar rruga rreth lumit, mirëpo planifikimi i vitit 2023 ka qenë 293,000.00E prapë për me fillu punimet aty.

Te vendimet gjyqësore shuma aty janë kryesisht për shujta të mësimdhënësve.

Te të hyrat vetanake në mënyrë analitike te gjobat nga inspektoriati i kam sqaruar dhe në Komitet, janë procedurë përbarimore disa vendime që i ka nxjerrur inspektoriati për gjobat e bizneseve, dhe besoj që do realizohen të hyra dhe në këtë sektor.

Te shfrytëzimi i pronës publike është qështja e bazenit të Banjës. Taks për qertifikatë të pronësisë dhe kopje plani është nga Gjeodezia.

Taksa për leje ndërtimi është një rritje që fatbardhsisht kemi një rritje të ndërtimeve të objekteve në qytetë dhe realizon dhe të hyra. Disa të hyra për mungesë të kodit, shfrytëzohen dhe kode tjera për të cilat duhet të realizohen të hyrat komunale.

Të hyra nga agjensioni nuk kemi të hyra në këtë tre mujosh.

Provizioni bankar ne bëjmë deponim te mjeteve çdo ditë.

Shërbimet e ndryshme intelektuale këtu hynë pagesa e disa komisioneve, por kemi dhe pagesa të shërbimeve konsullente.

Shërbimet e arsimit, trajnimet, tami kemi një marrveshje, një kontratë për realizimin e trajnimit në sektorin e arsimit dhe nuk është kryer pjesa e pagesës plotësisht.

Shërbimet kontraktuese tjera- ne kemi një kontrat për shërbime që kryhen dhe në shëndetësi që i kemi të angazhum. Në kuadër të kësaj kategorie hynë dhe shpenzimet e kontraktuara për shërbimet e pastrimit në komunë, por ka dhe shërbime të tjera kontraktuese.

Shërbimet e tjera teknike është që kryhet ndonjë shërbim teknik qoftë në mirëmbajtje.

Shpenzimet për antarsim kemi obligime si komunë në antarsimin në asosacionin kemi obligimë të pashlyera, tani kemi obligim dhe 20,000.00E si antarësi në asosacionin e komunave.

Nuk kemi kategori të peletit dhe të gjitha kanë hyrë te kategoria e druve.

Te shërbimet e varrimit te kjo qështje duhet të kemi parasysh sepse këtu është një zvogëlim i shërbimit të varrimit. Te kjo qështje duhet të kemi parasysh se kontrata është kryerdhe me përfundimin e kontratës janë kryer dhe obligimet ndaj operatorit dhe nuk ka mundur të realizohet kjo pjesa tjetër që ka mbetur pa kontratë.

Paisjet tjera janë dhe kjo pjesa e teknologjisë dhe kompjuterët në administratë që kanë qenë.

Furnizime zyre janë disa furnizime të cilat ndonjë periudhë kërkojnë më shumë dhe jemi shumë të paknaqur me qështjen e shërbimeve teknikenga operatorët që janë ngjedhur në nivelin qendror,

te qështja e fotokopjeve, printerëve, ngjyrave jemi shumë keq me furnizim. Reklama dhe konkurse -Radio Malisheva e ka njëmarrveshje me komunën tonë për publikim dhe njëkohësisht për konkurse që shpallen nga institucioni komunal.

Dreka zyrtare është qështja e realizimit të aktiviteve për ditën festivetë 17shkurtit dhe festat e marsit.

Te tabela 7.6 ndërtesat ju kam shpjeguar janë institucione shkollore që është ndërtuar një pjesë e shkollës në Turjakë, është kryer pagesa te kjo shkollë dhe është renovimi i QKMF-së dhe është kryesisht për ndërtesat publike komunale për të cilët është intervenu. Ndërtimi i rrugëve-kryesisht është rruga "Ibrahim Mazreku", kemi kryer dhe realizimin e shpenzimit për rrugën "Habib Berisha" janë dhe disa rrugë tjera lokale.

Te kanlizimet është qështja e obligimeve që kanë qënë më herët të vitit të kalum dhe nuk janë kryer deri në këtë periudhë.

Nebih, nuk është punuar në kolektor, ende operatori nuk ka fillu punimet tek kolektori. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

*Valon Mazreku:* Kryesues, disa prej Komitetve dhe Komisioneve që kanë buruar nga ky Kuvend, nuk janë paguar me protekstin që nuk janë të listuara me një vendim të kuvedit të legjislaturës paraprake, të cilat kanë me u paguar nga 50E 6 mbledhje. Kryesues, kisha kërkuar që të merresh me këtë qështje, të sillen cilat Komisione dhe Komitete nuk janë në atë vendim dhe të ndryshohet vendimi.

**Argjend Thaçi:** Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/276 datë:18.04.2023, për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin fiskal 2023. Urdhëro, drejtor!

**Belërim Thaçi:** Vitin e kaluar kemi pasur tejkallim i të hyrave vetanake të komunës tonë në shumën prej 286,373.78E dhe shpresojmë që këtë vit ti rrisim më shumë të hyrat vetanake. Për të realizuar shpenzimin e këtyre mjeteve në këtë vit kërkohet aprovimi dhe votimi në asamble. Ne si drejtori kërkojmë që të miratohet kjo kërkesë për bartjen e mjeteve. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

*Valon Mazreku:* Kryesisht të hyrat vetanake barten, kjo është e lejuar me ligj. Drejtor, vetëm desha të them me u siguru që edhe te bartja pavarësisht që jemi në një vit tjetër fiskal nuk duhet me u cenu grantet specifike. Grant specifik është granti i arsimit dhe i shëndetësisë dhe nëse kanë mbetur mjete të pa shpenzuara nga këto dy grante, të dy këto duhet të barten në të dy kto grante.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Ne vazhdimisht të hyrat vetanake i kemi destinuar aty ku nuk kemi mundur me shti një projekt dhe me të hyrat vetanake e kemi rregulluar atë projekt, për shkak të mungesës në

buxhet kanë dalur kërkesa të reja nga qytetarët dhe i kemi destinuar në atë pjesën ku nuk kemi mundur me prek.

Te sheshi qytetit është e planifikuar me buxhet dhe pse me u nda dhe 250,000.00E shtesë, kurse ne i kemi shumë projekte nëpër fshatra që nuk kemi mundur me i prek me projekt-buxhetin 2022-2023. Shkolla në Turjakë duhet të ndërtohet, mirëpo dhe ajo ka qenë e planifikuar me buxhet. Drejtor, unë mendoj që të shkojnë në projekte të tjera të cilat nuk janë në projekt buxhet.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** E dëgjova Valonin që tha që është mirë me i pas këto kategori prej ku janë ato mjete me u bart në kategorinë e njejtë dhe si planifikim. Por, unë në këtë kërkesë nuk po e shohë, përveq te shkolla Turjakës që janë 30,000.00E, ndërsa në dy kategoritë tjera që po kërkohen me u bart këto mjete nuk kanë të bëjnë asgjë me shëndetësinë dhe arsimin. 250,000.00E janë në sheshin e Dëshmorëve dhe e fundit mallra dhe shërbime 6,373.78. Kemi pasur zotim të mjeteve buxhetore për komplet shkollën e Turjakës, dhe tani po kërkohet 30,000.00E, a është dalur enkas ndonjë punë aty, pse me kerku shtesë prapë mjete. Sa i përket sheshit ndoshta do ishte mirë me i orientu të paktën një shumë me e shpërnda në kategori tjera, në kanalizime, në rrugë, sepse janë mbetur disa projekte që ka filluar vetëm faza e parë dhe është stopu ju kanë marrur mjetet dhe janë shkuar në projektet tjera, siq është rruga që lidh fshatin Banjë-Lladroc që është me interes.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Orientimi i mjeteve në këto projekte është i rëndësishëm, dhe ne si grup jemi pro kësaj kërkesë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Më mirë është të përfshihet ndonjë projekt që nuk janë të përfshirë në projekt buxhet. I shikova të gjitha projektet dhe fshati Damanek-Bubël-Qypevë është totalisht i anashkalun dhe do ishte mirë me i bartë me ndonjë projekt dhe për nevojat e qytetarëve të asaj ane.

**Argjend Thaçi:** Kërkoj mbështetjen e të gjithëve që kjo kërkesë të miratohet. Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaçi:** Valoni, e ngriti këtë shqetësimin, mirëpo i kemi analizuar dhe shqyrtuar të gjitha dhe të gjitha këto mjete kemi pasur mundësi me i dërgu në kapitale, mirëpo në aspektin simbolik i kemi lënë në pjesën mallra dhe shërbime. Sa i përket projekteve t reja, këto nuk mund të destinohen sepse duhet të jenë për kode ekzistuese. Pse janë qit në shesh është sepse sipas planifikimit të buxhetit ne i kemi 750,000.00E për këtë vit dhe kontrata është mbi 8,000,000.00E që të realizohet për tre vite.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Kur jemi te buxheti dhe te projekti Malisheva urbane, kam informata që komuna ka fillu të interesohet, te bisedojë dhe të kërkojë prej bankave një kredi në vlerë prej 10,000,000.00E. A është kjo realitet apo janë vetëm fjalë?

**Blerim Thaçi:** Komuna është e interesuar për realizimin e projektit dhe të gjejë mjetet. Kryetari i komunës është në kontakt dhe me qeverinë me Ministrinë e Infrastrukturës për mbështetje të këtij projekti. Kemi shqyrtuar he mundësinë e kredis, mirëpo janë disa kritere që duhet të përmbushen për me marr kredi.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e kërkesës nr.04/276 datë:18.04.2023, për bartjen e të hyrave vetanakë nga viti 2022 në vitin 2023?

Për:17

Kundër:6

Abstenim:5

Pika e radhës është Shqyrtimi i Planit vjetor të prokurimit dhe meqenëse shëfën e prokurimit nuk e kemi këtu kërkoj që të kalojmë në pikën e katërt dhe ta përmbyllim këtë seancë. Kalojmë në pikën e katërt formimi i këshillit organizativ për kremtimin e 16 qeshorit. Është një standart i formimit të këtij këshilli në bazë të praktikave të viteve të kaluara- kryetari, kryesuesi- drejtori për kulturë rini dhe sport, kryetari i shoqatave të dalura nga lufta dhe secili subjekt politikë nga një anëtarë. Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Nga Nisma propozojm Amrush Helshani.

**Argjend Thaçi:**Urdhëro, Hamit!

**Hamit Lima:** Nga LDK-ja propozojm Arlind Morina.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Nga PDK-ja propozojm Alban Kastratin

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Nga VV-ja propozojm Ilaz Krasniqi.

**Argjend Thaçi:** Nga AAK-ja Eqrem Morina.

Kush është për këto propozime?

Me vota uannime, formohet ky Komision.

Ju falenderoj për pjesmarrje!

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Përfundoi në ora: 16:30

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina

